

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË "SHALA COMPANY" SH.P.K.**

Sot, më datë 30/10/2024,

**Z. Reshat Shala**, shtetas Kosovar, i biri i Muje, lindur më 07/04/1969, në Pemishte, Kosove, banues në Rruga Nexhjet Basha Nr 21 30000 Pejë Kosovë, e mbajtës i kartes ID me nr 0408681, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligji nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeluan një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "SHALA COMPANY" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "SHALA COMPANY" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndërtesa Nr.3, Hyrja Nr.11, Kati 2, Ap. Nr.2.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.



## NENI 4

### OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Shoqëria do te ushtroje aktivitetin e saj ne shitje dhe blerje të pasurive të patundshme, në fushen e ndërtimit dhe fusha te tjera te ngjashme si dhe çdo veprimtari të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
- Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100,000 (Njëqind mijë) Leke dhe është i ndarë në 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- Z.Reshat Shala lindur me 07/04/1969, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 (Njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi administrativ i shoqërisë eshte Administrator I shoqerise :
- Z. Reshat Shala i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, nga 30/10/2024 – 30/10/2029, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje originale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Akitit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqerise.

### ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

*Z. Reshat Shala*

